

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
INSTITUCIONIN E PREFEKTIT TË QARKUT SHKODËR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 1.06.2013 deri më datë 01.06.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 106, datë 31.08.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 509/8, datë 31.08.2015, i ka rekomanduar z.Paulin Radovani, Prefekt i Qarkut Shkodër, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetjet nga auditimi: Gjatë vitit 2013 janë larguar nga puna 8 punonjës, ndërsa gjykata me vendim të formës së prerë, ka vendosur detyrimin e Institucionit të Prefektit të paguaj shumën 4,710.299 lekë, për zgjidhje të njëanshme të kontratës, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Rekomandim: Institucioni i Prefektit Qarkut Shkodër të marrë masa, që çdo largim të punonjësve nga puna, të bëhet duke zbatuar procedurat administrative dhe ligjore, me qëllim që në përballje në organet e drejtësisë të mos kemi pasoja negative për dëmshpërblime.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Pranimi i punonjësve në sektorin e PMNZH, është bërë pa konkurrencë sipas kërkesave ligjor, por vetëm me urdhër emërimi, në kundërshtim me nenin 10, pika 1, e ligjit nr. 8766 datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin” i ndryshuar. Janë pranuar e emëruar punonjës mbi moshën 35 vjeç, në kundërshtim me pikën 1.c, nenin 10 të ligjit nr. 8766 datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, i ndryshuar.

Rekomandim: Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër të marrë masa që për të gjitha pranimet e reja në PMNZH, të zbatohet procedurën me konkurrencë.

Vazhdimisht

3. Gjetje nga auditimi : Sektori i Financës nuk ka kryer kontabilizimin e të ardhurave në **vlerën 2,100 mijë lekë**, të siguruara nga aplikimi i shërbimeve të kryera nëpërmjet sektorit të PMNZSH-së ndaj të tretëve, sipas tarifave të përcaktuara në VKM nr. 285, datë 27.06.2002 “Për aplikimin e tarifave të shërbimit ndajë subjekteve të ndryshme”, në zbatim kjo të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, për regjistrimin në kontabilitet të veprimtarisë së PMNZSH-së, për të ardhurat në zbatim të ligjit nr. 7866, datë 05.04.2001 “Për Mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, i ndryshuar.

Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa dhe të kryej menjëherë veprimet kontabël duke kontabilizuar vlerën **2,100 mijë lekë** në llogarinë përkatëse. Për rastet e mos pagimit në mënyrë vullnetare të detyrimeve, të zbatohen kërkesat e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Sektorit të PMNZSH-së dhe Zyra e Financës në Institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër, nuk kanë arkëtuar të ardhurat e krijuara nga tarifat për shërbimet e kryera nga specialistët e PMNZSH, kryesisht të ardhurave për akt-ekspertimet nga Prokurorinë e Rrethit Shkodër dhe të Prokurorisë së Rrethit Pukë, nga të cilat nuk është xhiruar (paguar) për llogari të Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, vlera **2.100 mijë lekë**, në zbatim të VKM nr. 285, datë 27.06.2002 “Për tarifat e shërbimeve që kryen Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave juridikë e fizikë, vendas dhe të huaj”.

Rekomandimi: Sektori i PMNZSH-së dhe Zyra e Financës në Institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër, të marrin masa dhe të hartojnë programe pune dhe të ndiqen të gjitha hapat ligjorë, për arkëtimin e të ardhurave nga tarifat për shërbimet e kryera nga specialistët e PMNZSH, kryesisht të ardhurave për akt-ekspertimet për Prokurorinë e Kolegjit Gjyqësor Shkodër dhe të Prokurorisë së Kolegjit Gjyqësor Pukë.

Brenda muajit Shtator 2015

5. Gjetje nga auditimi: Rregjistri themelor i evidentimit të subjekteve që paguajnë çdo vit tarifën e akteve teknike nuk është i plotësuar sipas kërkesave të VKM nr. 285, datë 27.6.2002 “Për tarifën e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave juridikë e fizikë, vendas e të huaj”.

Rekomandimi: Njësia e parandalimit në PMNZSH të marrë masa dhe të mbajë regjistrin themelor të evidentimit të subjekteve të plotësuar dhe abdetuar me të dhënat që kërkohen, për të gjithë personat fizik dhe juridikë, që paguajnë tarifën e akteve teknike çdo vit, për pikat e karburantit, mjeteve autobot, pikave të tregtimit të gazit dhe njësitë e tregtimit të bombolave.

Vazhdimisht

6. Gjetje nga auditimi : Disa nga mjetet në inventar të Institucionit të Prefektit dhe të Sektorit të PMNZSH-së, nuk janë të pajisura me targa, të pa siguruara me kontratë sigurimi dhe pa kontrollin teknik.

Rekomandimi: Sektori i PMNZSH-së dhe Zyra e Financës në Prefekturë të marrë masa të menjëhershme për:

-Targimin e mjeteve të transportit, të paguhen kontratat e sigurimit me shoqëritë e sigurimeve, të mjeteve, në inventar të Prefekturës Shkodër dhe të zbatohen procedurat elektronike për kryerjen e siguracioneve.

-Të gjitha mjetet e sektorit të PMNZSH-së , t'i nënshtrohen kontrolli teknik të detyrueshëm, me qëllim që të kontrollohen nëse ato garantojnë sigurinë në qarkullim, dhe që ndotja e tyre nuk i kalon kufijtë e përcaktuar.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi : Në inventarin e institucionit, 21mjeje janë 100 % të amortizuara, po kështu 10 prej tyre, janë propozuar për jashtëpërdorimi, ndërkohë që vazhdojnë të mbahen gjendje në inventarin fizik e kontabël. Nga Institucioni i Prefektit, rezulton se është bërë një shkresa me nr. 1148, datë 17.06.2014, drejtuar Ministrit Brendshëm por ka mbetur pa përgjigje(*Trajtuar më hollësisht në faqe 37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi: Për mjetet që janë jashtë përdorimit dhe gjendje inventari fizik e kontabël, Sektori i Financës të rishqyrtojë procedurat e vlerësimit të tyre në vitin 2013 dhe në bazë të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të kryhen gjithë procedurat e nevojshme për nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në bilancin e Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër në llogarinë 212 : “Ndërtime e rikonstruksione”, paraqitet vlera e ndërtesës, ku gjendet aktualisht Bashkia Shkodër, ndërkohë që ambientet ku është akomoduar aparati Institucionit të Prefektit janë të Bashkisë Shkodër. Nuk është e hipotekuar: Objekti i Sektori PMNZSH Shkodër, ku kryhet aktiviteti (Godinë) është ndërtuar nga Prefektura por nuk rezulton të jetë hipotekuar .

Rekomandimi: Të merren masa nga të dy institucionet(Prefekti i Qarkut dhe Bashkia Shkodër) dhe të bëhen sistemimet kontabile dhe inventariale të objekteve ku ushtrojnë aktivitetin e tyre. Të programohet puna dhe të përcaktohen nevojat e burimeve njerëzore dhe materiale e financiare në kuadrin edhe të ndryshimeve në të ardhmen të pushtetit vendor, për zgjidhjen e problemit të administrimit dhe ruajtjes së aseteve, kalimit të pronësi të Institucionit të Prefektit të atyre që zotëron për aktivitetin e tij.

Brenda muajit Tetor 2015

9. Gjetje nga auditimi : Në auditimin e gjendjes së llogarive të paraqitura në bilancin e vitit 2013 dhe 2014, rezultoi se në llogarinë nr. 24 “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara”, është trashëguar vlera prej **195,000 lekë** , të cilës nuk i është dhënë zgjidhja ligjore(*Trajtuar më hollësisht në faqe 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi: Institucioni i Prefektit nëpërmjet Zyrës së Administrimit financiar, , të përcaktojë shkaqet e krijimit të këtij detyrimi, të përcaktojë kohën e krijimit, duke u bazuar në dokumnetacionin kontabël dhe mbi këtë bazë të dalë me konkluzione e vendime konkrete për sistemimin e shumës së mësipërme.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Në kontabilitetin e angazhimeve të Institucionit të Prefektit vazhdojnë të qëndrojnë gjendje, në llogaritë (423-429) debitorë të ndryshëm për shumën **691,021 lekë**, detyrime të lindura ndër vite, pa shpresë arkëtimi.

Rekomandimi: Institucioni i Prefektit të marrë të gjithë masat ligjore për sigurimin e arkëtimit të debitorëve të ndryshëm për shumën **691,021 lekë**.

Brenda muajit Nëntor 2015

11. Gjetje e auditimit : Gjendja et e e detyrimeve dhe të drejtave, konstatohet se është shqetësuese, konkretisht gjendja e llogarisë 401 për subjektin C.... shpk për vlerën 415,962 lekë, shumë e cila ka të bëjë me riparimin e një mjete që në vitin 2009 dhe që mbetet ende pa u likuiduar.

Rekomandimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër, pasi të analizojë në themel shkaqet e krijimit të këtij detyrimi, të nxjerrë përgjegjësinë përkatëse e mbi këtë bazë të të bëjë administrimin ligjor të detyrimit të mësipërm.

Brenda muajit Nëntor 2015

12. Gjetje nga auditimi : Për llogari të PMNZSH-së më 31.12.2014, rezulton një detyrim në vlerën 469,860 lekë, nga i cila: vlera 130,544 lekë krijuar që nga viti 2003, vlera 111,960 lekë nga vitit 2004 dhe vlera 227,356 lekë nga vitit 2005.

Rekomandimi : Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër, pasi të analizojë shkaqet e krijimit të këtij detyrimi, të nxjerrë përgjegjësinë përkatëse e mbi këtë bazë të të bëjë administrimin ligjor të detyrimit të mësipërm, duke gjetur rrugët dhe burimet e financimit për shlyerjen e tyre.

Brenda muajit Nëntor 2015

13. Gjetje nga auditimi: Në bilancin e vitit 2014, në llogarinë 467“Kreditorëve të ndryshëm” paraqitet shuma 872,674 lekë të krijuar në periudha kohe të ndryshme si: Në vitin 2001, 30,000 lekë, në vitin 2002, shuma prej 47,350 lekë, në vitin 2003, shuma 326,390 lekë, në vitin 2004, shuma 106,400 lekë, në vitin 2005, shuma 347,534 lekë dhe në vitin 2007, shuma 15,000 lekë (*Trajtuar më hollësisht në faqe 39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi : Institucionit i Prefektit të Qarkut Shkodër, pasi të analizojë shkaqet e krijimit të këtij detyrimi të nxjerrë përgjegjësinë përkatëse e mbi këtë bazë të të bëjë administrimin ligjor të detyrimit të mësipërm

Brenda muajit Nëntor 2015

14. Gjetje nga auditimi: Në Sektorin e PMNZSH-së Pukë, nuk është bërë hyrje mjete Kamionçinë, Tip Ford transit i dhuruar nga donatorë austriak në vitin 2014. Për mungesë të përcaktimit të vlerës së tij.

Rekomandimi: Zyra e Administrimit financiar në Institucionin e Prefektit së bashku me PMZSH Pukë, të marrin masa për bërjen hyrje të mjetit Kamionçinë tip Ford transit.

Brenda muajit Tetor 2015

15. Gjetje nga auditimi: Dokumentet, vendimet dhe materialet hartografike të krijuara, nga KV- ja nuk janë administruar në format elektronik, siç përcaktohet në VKM nr. 1, datë 27.3.2009 “Për miratimin e rregullores për organizimin e komisioneve vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë”, nuk janë të skanuara.

Rekomandim: Drejtori i KVVTP-së dhe Prefekti i Qarkut të marrin masa konkrete, për sigurimin e mjeteve elektronike si aparat skanimit, disketa, të nevojshme për administrimin, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave që gjenerohen nga të tretët, për të ofruar një shërbim sa më të mirë, cilësor dhe në kohë.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi : Gjatë vitit 2014 dhe 5/mujorit të vitit 2015, nga KVVTP Shkodër, rezulton se, nga vendimet e marra, janë dërguar pranë Sekretariatit Teknik të Komisionit Qeveritar të Tokës, dosjet e 16 ankimueseve për 16 vendime, për të cilat Komisioni Qendror i Tokës, mbas shqyrtimi të tyre, ka dal me vendimet përkatëse. Nga KVVTP Shkodër, është filluar nga procedura për plotësimin e hetimeve . Nuk ka gjetur zbatim afati 7 ditor nga data e miratimit të vendimeve të KQT-së.

Rekomandimi: Drejtori i KVVTP-së dhe Titullari i Institucionit të Prefektit të Qarkut të marrin masa konkrete për plotësimin hetimor të dosjeve, që trajtohen në vendimet mësipërme dhe daljen me vendime përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

Brenda muajit Shtator 2015

17. Gjetje nga auditimi : Drejtoria e KVVTP-së ka marrë 45 vendime me objekt shfuqizim të plotë/pjesëshëm për 95,720 m², sipërfaqe toke të liruar në favor të shtetit dhe 136,553 m² sipërfaqe toke në favor të komunave , gjithsej 232,273 m² , sipërfaqe këto të përfituara në kundërshtim me ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 “ Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar dhe 45 vendimet e marra janë dërguar në Gjykatë Administrative dhe janë proces gjykimi .

Rekomandimi: KVVTP dhe Institucioni i Prefektit Qarkut Shkodër të marrin masa, për ndjekjen e gjithë proceseve gjyqësore deri në përmbushjen e misionit sipas vendimeve të marra dhe mbi bazën e vendimeve të marra nga Gjykatat Administrative të bëhet ndjekja e zbatimit të tyre në ZVRPP dhe njësitë vendore përkatëse .

Në vazhdimësi

18. Gjetje nga auditimi : Drejtoria e KVVTP-së ka marrë 15 vendime me objekt shfuqizim të plotë/pjesëshëm për sipërfaqe toke të transaktuar në favor të tretëve dhe detyrim monetar, bazuar në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 “ Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar me ligjin nr. 58, datë 17.05.2012, si dhe ligjin 176 /2013 datë 16.12.2013, “ Për disa ndryshime të ligjit 9948, datë 07.07.2008 “ Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar, neni 9, pika 6. Gjendur para një fakti të tillë, nga KVVTP për të 15 vendimet, janë llogaritur **13.947,338 lekë** detyrime monetare për periudhën 2014 dhe 5/mujorin vitit 2015, që janë mungesë të ardhurash për buxhetin e shtetit.

Rekomandimi: KVVTP , pranë Institucionit Prefektit Qarkut Shkodër të marrë masa për ndjekjen e gjithë proceseve gjyqësore dhe mbi bazën e vendimeve që do të marrë Gjykata Administrative, të vazhdohet ndjekja e zbatimit të tyre, deri në përmbushjen e misionit për arkëtimin e detyrimeve të lindura. Ndërkohë sipas kompetencave ligjore të dërgohet shkresë zyrtare për të 15 vendimet, për masë kufizimi të këtyre pronave në ZVRPP-në përkatëse, deri në mbarimin e procesit gjyqësor, kjo të shërbejë si masë parandalimi për moskryerjen e transaksioneve të ndryshimit të pronësisë.

Brenda muajit Shtator 2015 e vijim

19. Gjetje nga auditimi : Drejtoria e KVVTP gjatë verifikimit të dokumentacionit ka konstatuar se nga KV-ja e Qarkut Shkodër janë marrë 45 vendimet, ku titulli i pronësisë mbi tokën bujqësore është lëshuar në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në nenet 2,3 dhe 4, të Kreut 1 të tij, për të cilat me të drejtë, janë dërguar në Gjykatën Administrative dhe janë proces gjykimi.

Rekomandimi: Nga KVVTP , pranë Institucionit Prefektit Qarkut Shkodër të merren masa për ndjekjen e gjithë proceseve gjyqësore. Ndërkohë sipas kompetencave ligjore të dërgohet shkresë zyrtare për të 45 vendimet, për masë kufizimi të këtyre pronave në ZVRPP-në përkatëse, deri në mbarimin e procesit gjyqësor, kjo të shërbejë si masë parandalimi për moskryerjen e transaksioneve të ndryshimit të pronësisë.

Brenda muajit Shtator 2015 e vijim

B. MASA SHPËRBLIM DËMI:

Prefekti i Qarkut Shkodër të marrë masa dhe të kryej kontabilizimin e detyrimeve, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim *për shpërblimin e dëmit* si më poshtë:

1. Gjetje të auditimit: Janë paguar 6 gjashtë punonjës kundërshtim me VKM nr. 997 datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, për dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën **5.130 lekë**

Rekomandimi: Nga Zyra e Administrimit Financiar në Prefekturë, të merren masa për ndalimin e vlerave të paguar për dieta udhëtimi brenda vendit”, për dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën **5.130 lekë**.

Brenda muajit Tetor 2015

2- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit autoveturës SH 8841 E dhe AA 362 të Institucionit të Prefektit , rezultoi se: në Fletudhëtimet e muajit Qershor-Gusht të mjetit SH 8841 E për vitin 2013 si dhe gjatë vitit 2014 e 5/mujori 2015, janë plotësuar padrejtësisht jashtë destinacionit të miratuar, *jo në përputhje me distancat kilometrike(Tiranë –Shkodër dhe*

anasjelltas), të cilat nuk justifikojnë harxhimin e 342.6 litrave karburant për vlerën 63.805 lekë dëm ekonomik.

-Nga rakordimi vjetor 2013, për km e përshkuara, krahasuar me furnizimet (*bazuar në fletëdaljet e magazinës si dhe në normativën e karburantit të aprovuara sipas procesverbaleve të komisionit, (9.6 litra /100 km) për mjetin Sh 8841,nuk argumentohen 251.48. litra naftë nga të cilat 233.1 litra me vlerë gjithsej 44,830 lekë mbetet në përgjegjësi të z. F.Sh dhe 18.38 litra me vlerë 3.249 lekë në përgjegjësi të z. F.Gj.*

-Nga rekordimi vjetor 2014 për km e përshkuara furnizimet .normativat e karburantit (*12.6/100*), sipas procesverbaleve të komisionit rezulton diferenca e pajustificuar për 91.1 litra karburant me vlerën *15,726 lekë* dëm ekonomik, për drejtuesin e kamionit.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera 63,805 lekë përkatësisht nga F.Sh *44,830 lekë* dhe F.Gj 18,975 lekë, shpenzim i pa justifikuar me dokumente, dhe lëvizje jashtë destinacionit të miratuar, për vitin 2013-2014 dhe 5/mujorin e vitit 2015.

Brenda muajit Tetor 2015

C. MASA DISIPLINORE :

- Në zbatim të ligjit nr. 152/ 2013, miratuar më datën 30.5.2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, i kemi rekomanduar Prefektit të Qarkut Shkodër, që të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “*Vërejtje me paralajmërim*” deri në “*Largim nga puna*”, për:

1-Znj. D.B , me detyrë Përgjegjëse e sektorit shërbimeve të brendshme e cila mbulon edhe burimet njerëzore për :

-Gjatë periudhës objekt auditimi, rezulton se janë liruar nga detyra gjithsej 32 punonjës nga të cilët 20 punonjës nga Administrata e Prefektit dhe 12 nga sektori i PMNZSH-së.

Nga të dhënat rezulton se 7 punonjës kanë ngritur padi gjyqësore dhe kanë fituar gjyqin në të gjitha shkallët për një detyrim total në vlerën 4,710,299 lekë nga të mbetet pa likuiduar detyrimi për 2,926,134 lekë.

-Për punonjësit e larguar nga puna, të cilët kanë fituar të drejtën në gjykatë, në asnjë rast nuk ka dalë përgjegjësia e urdhëruesve .

-Për vitin 2014 në 5 raste, vërtetohet se emërimet e punonjësve janë bërë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në nenin 10, pika 1, paragrafi c të ligjit nr. 8766 datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin” i ndryshuar, ku citohet se duhet të jenë nën moshën 35 vjeç.

Nuk përbën argument justifikimi i Përgjegjësës së sektorit të shërbimeve të brendshme që mbulon edhe burimet njerëzore se, emërimet janë bërë nga instanca të tjera. Nga dokumentet e paraqitura nuk u gjend asnjë gjurmë ku të jenë kundërshtuar veprimet në lidhje me procesin e emërimeve .

- Punësimi i punonjësve të PMNZH nuk është bërë me konkurrim por vetëm me urdhër emërim, në kundërshtim me nenin 10, pika 1, e ligjit nr. 8766 datë 05.4.2001, i ndryshuar.

2- z. M.D, me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Administrimit Financiar, për :

-Pagesën e gjashtë punonjës në vlerën *5,130 lekë dëm ekonomik*, në kundërshtim me VKM nr. 997 datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”.

-Nuk është kryer kontabilizimi i të ardhurave në *vlerën 2.100 mijë lekë*, të siguruar nga aplikimi i shërbimeve nga sektori i PMNZSH-së ndaj të tretëve sipas tarifave të përcaktuara - Nuk janë arkëtuar të ardhurave e krijuara nga tarifat për shërbimet e kryera nga specialistët e PMNZSH, kryesisht të ardhurave për akt-ekspertimet nga Prokurorinë e Rrethit Shkodër dhe të Prokurorisë së Rrethit Pukë , nga të cilat nuk është xhiruar për llogari të Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, vlera për *shumën 2.100 mijë lekë*, nga e cila për vitin 2013 rezultojnë të pa arkëtuar 550 mijë lekë dhe për vitin 2014 të pa arkëtuar 800 mijë lekë dhe 5/mujorin e vitit 2015, 750 mijë lekë, në zbatim të VKM nr. 285, datë 27.06.2002 “Për tarifat e shërbimeve që kryen Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave juridikë e fizikë, vendas dhe të huaj.

-Për mos sistemimin e tepricës së gjendjes së tepricës së llogarisë nr. 24 “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara”, vlera prej *195,000 lekë* , të cilës nuk i është dhënë rrugëgjdhja ligjore

-Për mos ndjekjen e arkëtimeve të tepricës së llogarisë 468 për shumën 69

-Për mos sistemimin e gjendjes së llogarisë (423-429) debitorë të ndryshëm të shumës 691,021 lekë, detyrime të lindura ndër vite, pa shpresë arkëtimi).

-për mos ndjekjen dhe sistemimin e tepricës së llogarisë 467“Kreditorëve të ndryshëm” për shumën 872,674 lekë të krijuar në periudha kohe të ndryshme .

3. Znj.S.R me detyrë Drejtor i Komisionit të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë prej shkurtit 2014, për:

Për vendimet e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë nr. 197datë 24.04,2011, nr. 199, 200, 201, datë 11.07.2014, vendimeve nr. 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224, 225 dhe 226, datë 11,11.2014. Vendimet e mësipërme janë ankimuar në KQT Tiranë . Komisioni Qeveritar i Tokës pasi ka vendosur: “ Pranimin e ankimit, ka bërë shfuqizimin e vendimeve të KV Shkodër, dhe kthimin në Komisionin Vendor me qëllim të plotësimit të hetimeve dhe rishqyrtimin e tyre me vendimet nr .24, dt,17.10.204, nr. 2, nr. 4, nr. 3, nr. 10, nr. 9, nr. 16, nr. 8, nr. 6, nr. 5, nr. 15, datë 11.02.2015.

-Për vendimet e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë nr. 215, datë 10.10.2014 i shfuqizuar me vendimin e KQT-së nr 12, datë 11.02.2015

-Për vendimet e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë nr. 216, datë 11.11.2014 i shfuqizuar me vendimin e KQT-së nr 21, datë 11.02.2015

Për vendimet e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë nr. 227, datë 11.11.2014 i shfuqizuar me vendimin e KQT-së nr 17, datë 11.02.2015.

III - Në zbatim të kreut IV, neni 11, shkronja “e” dhe “ç” dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, i kemi rekomanduar Prefektit të Qarkut Shkodër, që për shkeljet e konstatuara, të fillojë procedura për marrjen e masave disiplinore: **“Vërejtje me paralajmërim”** deri në **“Ndërrerje të marrëdhënieve të punës”**, për:

1. znj.A.U, juriste filluar punë më datë 23.12.2009, në vazhdim;

Për vendimet e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë nr. 197datë 24.04,2011, nr. 199, 200, 201, datë 11.07.2014, vendimeve nr. 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224, 225 dhe 226, datë 11,11.2014. Vendimet e mësipërme janë ankimuar në KQT Tiranë . Komisioni Qeveritar i Tokës pasi ka vendosur: “ Pranimin e ankimit, ka bërë shfuqizimin e vendimeve të KV Shkodër, dhe kthimin në Komisionin Vendor me qëllim të plotësimit të hetimeve dhe rishqyrtimin e tyre duke dalë me vendim nr. 24, dt,17.10.204, nr. 2, nr. 4, nr. 3, nr. 10, nr. 9, nr. 16, nr. 8, nr. 6, nr. 5, nr. 15, datë 11.02.2015.

2. znj.S.C me detyrë (juriste) filluar punë në shtator 2013, në vazhdim;

-Për vendimin e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë nr. 215, datë 10.10.2014 i shfuqizuar me vendimin e KQT-së nr 12, datë 11.02.2015

-Për vendimin e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë nr. 216, datë 11.11.2014 i shfuqizuar me vendimin e KQT-së nr 21, datë 11.02.2015

Për vendimin e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë nr. 227, datë 11.11.2014 i shfuqizuar me vendimin e KQT-së nr 17, datë 11.02.2015.

D. TË TJERA

Në vlerësimin e kryer mbi zbatimin e standardeve dhe cilësinë e auditimit,për plotësimin e programit të auditimit, auditimi i kryer mbi veprimtarinë e Komisionit të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë institucionit të Prefektit Shkodër, **vlerësohet e dobët, dhe si e tillë do të rikryhet auditim me grup tjetër audituesish shtetëror në një kohë të përshtatshme. Auditimi do të kryhet, për një rivlerësim dhe rishikim dhe plotësim të pikave të programit që nuk janë realizuar plotësisht në lidhje me veprimtarinë e këtij komisioni.**

Nga Prefekti i Qarkut Shkodër është kthyer përgjigje sëbashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit te detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Halil Isufi, Bashkim Shehu dhe Rajmond Koçi, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT